

VENDIM
Nr. 441, datë 10.9.2021

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË,
KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE TË
SHQIPËRISË, QARKU DURRËS, Z. DENIS MEHMET DELIU**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163, pika 7 dhe 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 1901/1 prot., datë 10.9.2021, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar për shkak të dorëheqjes, të z. Lefter Haki Koka, i zgjedhur deputet në zonën zgjedhore, qarku Durrës, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Partia Socialiste e Shqipërisë është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 69, datë 15.2.2021.

Komisioni Rregullator, me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara më datë 25.4.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 408, datë 23.6.2021 miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues, si dhe rirenditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese, në zonën zgjedhore qarku Durrës për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.4.2021.

Sipas këtij vendimi, Partia Socialiste e Shqipërisë, për zonën zgjedhore qarku Durrës, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.4.2021, ka fituar 8 (tetë) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Durrës, janë:

Numri rendor 1 (një) znj. Milva Vilson Ekonomi, numri rendor 2 (dy) z. Alban Viktor Xhelili, numri rendor 3 (tre) z. Jurgis Shefqet Qyrbja, numri rendor 4 (katër) znj. Klodiana Fatmir Spahiu, numri rendor 5 (pesë) z. Ilir Muhamet Ndraxhi, numri rendor 6 (gjashtë) z. Rrahman Rexhep Rrahja, numri rendor 7 (shtatë) z. Lefter Haki Koka, numri rendor 8 (tetë) z. Edi Kristaq Rama.

Rezulton se lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Durrës, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 163, pika 7 dhe nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 408, datë 23.6.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilin është miratuar rirenditja e kandidatëve të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi rezulton se, kandidatit të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 9, (nëntë) z. Denis Mehmet Deliu.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Për sa më sipër, kandidati për deputet, z. Denis Mehmet Deliu, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 1673 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Durrës, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Denis Mehmet Deliu, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit konstatoj se, të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Durrës, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Denis Mehmet Deliu, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Lefter Haki Koka, i përket kandidatit vijues në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste, në zonën zgjedhore, qarku Durrës, i renditur me numër rendor 9, (nëntë) z. Denis Mehmet Deliu.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163 pika 7 dhe 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

VENDOS:

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore qarku Durrës, z. Denis Mehmet Deliu.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Ilirjan Celibashi